



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:262529

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05801023

C.nr.383/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Jeton Krasniqi dhe bashkëpunëtorin profesional Dardan Elshani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.G nga Komuna e Gllogocit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.Q nga Prishtina, kundër të paditurës Drejtoria e Arsimit-Komuna e Gllogocit, me objekt kontesti anulim i Vendimit të Drejtorisë Komunale në Drenas 09... të datës 16.10.2023 dhe caktim në vendin e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 13.05.2024, në prezencën e përfaqësuesit të palës paditëse, e në mungesë të paditurës, ndërsa me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET E PA BAZUAR kërkesëpadia e paditëses M.G nga Komuna e Gllogocit, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Drejtorisë Komunale në Drenas me nr... i datës 16.10.2023, të detyrohet Drejtoria për Arsimit që të njëjtën t'a zgjedh në vendin e punës si mësimdhënëse në lëndën E... dhe të detyrohet e paditura që t'i paguaj shpenzimet e procedurës prej 530.00 €.

A r s y e t i m

Paditësja M.G, përmes të autorizuarit të saj me datë 30.11.2023 ka ushtruar padi pranë kësaj Gjykate, kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gllogoc, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses dhe të anulohet vendimi i të paditurës me nr... i datës 16.10.2023, të detyrohet Drejtoria për Arsimit që të njëjtën t'a emëroj në vendin e punës si mësimdhënëse në lëndën E... si dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 530.00€.

Tutje ka theksuar se paditësja brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë komisionit për shqyrtimin e ankesave pranë DKA-së, e cila ankesë është refuzuar, ku në arsyetimin e këtij vendimi shihet se DKA në Drenas, kundërligjshëm ka favorizuar mësimdhënësin, duke mos u lëshuar fare në shqyrtimin e argumenteve dhe provave të paraqitura në ankesë. I njëjti është pranuar si mësimdhënëse në SHML "GJ..." në Drenas me përgatitje Akademike Bachelor Pedagogjisë së

Përgjithshme Muzikore ECTS (kredi 246), duke refuzuar tani paditësen M.G për të njëjtin vend të punës me përgatitje Master-Pedagogji e përgjithshme Muzikore me ECTS(kredi 241+120). Me këtë rast është shkaktuar diskriminim i paraparë me nenin 5 të ligjit të punës 03/L-212, Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi 05/L-021, po ashtu neni 14 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Tutje ka shtuar se nuk janë përfillur dispozitat ligjore të Ligjit për Zyrtar publik përkatësisht neni 64 pika 1 si dhe neni 8 pika 2 e Ligjit të punës si dhe tërë procedura në bazë të udhëzimit Administrativ 07/2017 për rregullimin e procedurës dhe themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik. Se komisioni ka bërë shkelje të procedurës transparente duke mos i publikuar rezultatet e kandidateve në procedurë pas intervistimit me shkrim dhe me gojë. Po ashtu komisioni ka bërë shkelje të udhëzimit administrativ U.A 05/2021-MASHT, ku kualifikimi i kërkuar sipas këtij udhëzimi administrativ për Shkollën e Mesme të Lartë neni 7 pika 21.1 kërkohej niveli Master-Pedagogji e Përgjithshme Muzikore me ECTS(300 pike), e që e njëjta përmban me shumë se 360 kredi. Se komisioni ka shkelur edhe pikën e konkursit tek kushtet e punësimit, ku për vendin e punës Mësimdhënës/e për E... me kohë të pa caktuar është kërkuar fakulteti përkatës sipas U.A 05/2021 dhe në rastin konkret komisioni nuk e ka përfillur këtë pikë dhe është përcaktuar për kandidatin tjetër i cili nuk e ka plotësuar këtë kriter dhe ka pasur gjithsej 246 kredi.

Përfaqësuesi i paditëses gjatë seancave të mbajtura ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe deklaramëve të kaluara. Ka shtuar se e ka pranuar një kopje të dokumentacionit të ofruara nga e paditura, mirëpo ka theksuar se nuk janë të mjaftueshme si dokumentacion në mënyrë që të vërtetohet saktësisht nëse kjo procedurë është zhvilluar sipas Ligjit. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara deri me tani është vërtetuar baza juridike e po ashtu edhe rrethanat tjera të kundërligjshme për vendimin mbi punësimin e mësimdhënësit K.H. Në rastin konkret mësimdhënësi nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas konkursit duke marrë për bazë përgatitjet akademike Bachelor i pedagogjisë së përgjithshme Muzikore me 246 kredi, duke mbetur larg pikëve të kandidateve tani paditëses me përgatitje Master Pedagogji e Përgjithshme Muzikore me 241+120 kredi. Tutje ka theksuar se është shkaktuar diskriminim i paraparë nga neni 5 i ligjit të Punës, po ashtu nuk janë respektuar dispozitat ligjore për zyrtar publik, përkatësisht neni 64 pika 1 dhe neni 8 i ligjit për zyrtar publik.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pala e paditur Drejtoria e Arsimit-Komuna e Glllogocit, në përgjigje në padi ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse si të pa bazuar. Ka theksuar se me datë 30.08.2023 ka rishpallë konkurs të brendshëm në SHML “GJ...” në Drenas për një mësimdhënës/e për E... me kohë të pa caktuar, ku në këtë konkurs ka aplikuar edhe paditësja, ndërsa me date 05.10.2023 Komisioni përzgjedhës ka publikuar listën e kandidateve/aplikuesve të cilët i kanë plotësuar kushtet për të ju nënshtruar fazës së parë të procedurës rekrutuese. Pas testimit me shkrim Komisioni përzgjedhës përmes njoftimit nr.prot... ka njoftuar kandidatët të cilët kanë qenë të suksesshëm në testimin me shkrim, ndërsa në intervistë me gojë janë ftuar K.H dhe M.G. Sipas vendimit të datës 16.10.2023, ka përzgjedhur kandidatin e suksesshëm për vendin e punës ashtu siç përcaktohet me nenin 12 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik. Tutje ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se kinse komisioni përzgjedhës ka bërë diskriminim profesional dhe gjinor ndaj palës

paditëse sepse udhëzimi administrativ nr.05/2021, në mënyrë të qartë ka përcaktuar nivelin arsimor adekuat për lëndën E... Sipas formularëve të vlerësimit të kandidatëve sipas pikëve të fituara gjatë testit me shkrim dhe intervistës, kandidati i përzgjedhur ka fituar më shumë pikë sesa paditësja. Andaj konsideron se komisioni përzgjedhës me rastin e zhvillimit të procedurës rekrutuese ka vepruar brenda kompetencave të tij dhe komfor legjisacionit në fuqi duke shtuar se kërkesëpadiisë se paditëses i mungon baza ligjore si dhe paditësja gjatë parashtrimit të padisë nuk ka prezantuar asnjë provë të besueshme për ti vërtetuar pretendimet e saj.

E paditura nuk ka marr pjesë në seancat e mbajtura në këtë proces gjyqësor, por me anë të parashtrësive të datës 27.03.2024, të datës 18.04.2024, të datës 10.05.2024, ka shprehur qëndrimet e saj duke kundërshtuar nga të gjitha bazat kërkesëpadiinë e paditëses.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Meqenëse e paditura nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt por mungesë e saj nuk e ka arsyetuar pastaj gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses duke u bazuar në nenin 423.4 të LPK-së ka marrë aktvendim dhe seancën kryesore e ka mbajtur në mungesë të paditurës.

Provat dhe gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë e të plotë të gjendjes faktike dhe nxjerrjes së vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, ka bërë administrimin e provave si: Diploma e paditëses lëshuar nga Fakulteti I Arteve në Prishtinë-Universiteti I Prishtinës “Hasan Prishtina” me dt. 24.07.2019 me nr... Diploma e paditëses lëshuar nga Fakulteti I Arteve në Prishtinë në UP “Hasan Prishtina” me dt. 17.09.2023 nr... Licencë e mësimdhënësit me nr... me datë të skadimit 26.03.2026, Certifikatë për mësimdhënësen M.G lëshuar nga MASHT në vitin 2022, Konkurs I brendshëm I Komunës së Drenasit-Drejtoria për Arsim nr... të dt. 02.08.2023, Rishpallje e konkursit të brendshëm I Drejtorisë për arsim nr... të dt. 30.08.2023, Njoftim I Drejtorisë Komunale të Arsimit 09... të dt. 13.10.2023, Ankesa e paditëses parashtruar të të paditurës me dt. 20.10.2023 me shenjen 01... Vendim I Drejtorisë për Arsim të dt. 16.10.2023 nr... Vendimi I Komunës së Drenasit – Komisioni I ankesave për nëpunësit e shërbimit publik 01-nr... të dt. 27.10.2023, Njoftimi nga drejtori I arsimit M.Gj për rezultatin e testit me shkrim përmes emailit, për paditësen të dt. 20.10.2023, Lista e kandidateve që I kanë plotësuar kriteret për testin me shkrim 09... të dt.06.09.2023 dhe 08.09.2023, Lista e kandidateve që I kanë plotësuar kriteret në testin me shkrim në bazë të konkurseve të dt. 02.10.2023, me nr... Lista e kandidateve që i kanë plotësuar kriteret e testit me shkrim të dt. 05.10.2023 me nr... Formular I vlerësimit të kandidateve për mësimdhënësit të nivelit arsimor 1,2 dhe 3 për vitin shkollor 2023/2024, në Gj... i dt. 16.10.2023, Formulari I vlerësimit të përbashkët nga 3 anëtarët e komisionit për kandidaten M.G, K.H, Formular I vlerësimit të anëtareve të komisionit që e kanë plotësuar formularin L.P, S.N dhe A.C për kandidatët K.H dhe M.G, Rekomandimi I komisionit për mësimdhënës në bazë të kriterëve të konkursit I dt. 16.10.2023, Vendimi I Komunës së Drenasit I dt.16.10.2023 me nr... Ankesa e dt. 20.10.2023 me numër... Vendimi I komisionit për ankesa për nëpunësit e shërbimit publik 01 nr... I dt. 27.10.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata me leximin e rishpalljes së konkursit të brendshëm numër 09... të datës 30.08.2023, vërtetoi faktin se konkursi ishte shpallur nga Drejtoria e Arsimit në Drenas për një mësimdhënës/e për E... me kohë të pa caktuar në SHML "GJ..." në Drenas.

Nga njoftimi i Drejtorisë për Arsim i Komunës së Drenasit nr... i datës 13.10.2023, vërtetohet se testin me shkrim e kishin kaluar K.H dhe M.G dhe të njëjtit do ti nënshtroheshin edhe intervistës me gojë.

Me leximin e vendimit nr... të dt. 16.10.2023, gjykata vërtetoi faktin se në SHML "GJ..." në Drenas, si mësimdhënës në kohë të pa caktuar ishte përzgjedhur kandidat i suksesshëm K.H.

Në bazë të ankesës të dt.20.10.2023, ndaj vendimit Nr... gjykata vërtetoi faktin se paditësja i ishte drejtuar Komisionit për ankesa në Komunën e Drenasit, me ankese për shkak të shkeljeve esenciale ligjore dhe përmbajtësore.

Gjykata me leximin e vendimit të komisionit të ankesave të Komunës së Drenasit nr... të datës 27.10.2023 vërtetoi faktin se paditëses i ishte refuzuar ankesa.

Me leximin e formularit të vlerësimit të kandidatëve për mësimdhënës të nivelit arsimor 1,2,3 për vitin shkollor 2023/2024, vërtetohet se paditësja kishte arritur 66.5 % të pikëve dhe e njëjta në bazë të pikëve të arritura ishte renditur e dyta , ndërsa i përzgjedhur nga ky konkurs ka qenë kandidati K.H i cili kishte arritur numrin më të madh të pikëve në mesin e kandidatëve më gjithsej 66.83 %.

Çështjet jo kontestuese dhe faktet jokontestuese për palët dhe Gjykatën në këtë çështje juridike - kontestimore sipas rrethanave të çështjes dhe sipas pretendimeve nga palët ndërgjyqëse paraqiten të jenë:

- Nuk ishte kontestuese për palët fakti se paditësja kishte aplikuar në konkursin e shpallur nga DKA në Drenas nr... të dt. 23.07.2020 dhe se e njëjta i ka plotësuar kushtet për t'iu nënshtuar këtij konkursi.

Çështjet kontestuese dhe faktet kontestuese për palët dhe Gjykatën në këtë çështje juridike-kontestimore bazuar në rrethanat e çështjes dhe sipas pretendimeve të ngritura nga palët ndërgjyqëse paraqiten të jenë:

- Fakti se kandidati K.H, i përzgjedhur në vendin e punës si mësimdhënës i lëndës E... në SHML "GJ..." në Drenas, në bazë të vendimit 09... të dt.16.10.2023, a i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas konkursit.

Për aplikimin e së drejtës procedurale dhe materiale Gjykata e vlerëson si të rëndësishme që të ritheksoj për palët se gjatë procedimit në një çështje juridike-kontestimore, bazuar në dispozitat

e Ligjit për Procedurën Kontestimore në fuqi, e njëjta vendos brenda kufijve të kërkesave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse.

Palët kanë për detyrë që të paraqesin faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre dhe ti propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, pra secila nga palët ka për detyrë që të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta.

Baza ligjore

Me nenin 8 të Ligjit nr.03/L-2012 të Punës është përcaktuar se *“Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës”*, ndërsa në par.2 të nenit të njëjtë është përcaktuar se *“Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”*. Me nenin 74 par.3 të Ligjit NR. 06/L – 114 për zyrtarët publikë është përcaktuar se *“Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave”*. Sipas nenit 4 paragrafi 1 të udhëzimit administrativ (MPMS) 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, përcaktohet se *“Konkursin publik për plotësimin e vendeve të lira të punës, e shpall organi kompetent i autorizuar me statutin apo aktin e brendshëm”*, ndërsa në paragrafin 6 të të njëjtit nen përcaktohet se *“Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, organi përkatës i autorizuar me statutin apo aktin e brendshëm duhet fillimisht të shpallë konkurs të brendshëm, nëse ka me shumë se një kandidat që i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin e vendit të lirë të punës”*. Neni 11 i të njëjti udhëzimit përcakton se *“Komisioni i përzgjedhjes fton në intervistë pjesëmarrësit e testimit me shkrim të cilët kanë fituar 50% e më shumë të pikëve”*, ndërsa me nenin 12 parashihet *“Komisioni i përzgjedhjes nxjerr vendim për përzgjedhjen e aplikuesit i cili ka më së shumti pikë në listën definitive”*. Me nenin 6 paragrafi 14 të udhëzimit administrativ nr.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm si të kualifikuar për lëndën E... parasheh *“14.1 Niveli Master-pedagogji e përgjithshme muzikore; 14.2 Sistemi katërvjeçar dhe 14.3 Bachelor-pedagogji e përgjithshme muzikore”*.

Vlerësimi i gjykatës

Gjykata pasi që i ka analizuar të gjitha provat ka vërtetuar se e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit në Drenas me datë 30.08.2023 ka shpallur konkurs për një mësimdhënës/e për lëndën E... në kohë të pacaktuar në SHML “GJ...” në Drenas. Për këtë pozitë, kishin aplikuar 5 kandidat në mesin e të cilëve ishte edhe paditësja. Të njëjtit i kanë plotësuar kushtet ligjore për aplikim në kuptim të nenit 6 par.14 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Në bazë të njoftimit të dt.13.10.2023 Drejtoria Komunale e Arsimit kishte shpallur rezultatet e testit me shkrim ku 2 kandidatë prej tyre kishin kaluar dhe ishin ftuar për intervistim me gojë. Komisioni për intervistim dhe vlerësim të kandidatëve konkurrent në bazë të pikëve të fituara në testin me shkrim dhe me gojë ka përzgjedhur K.H si kandidatin më të suksesshm me gjithsejtë 66.83%, ndërsa paditësja nga testi me shkrim dhe intervista me gojë kishte marrë 66.5 % të pikëve dhe ishte renditur në vendin e dytë. Pastaj paditësja e pa kënaqur me vendimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Drenas, kishte ushtruar ankesë pranë Komisionit për ankesa në Komunën e Drenasit, por Komisioni i ankesave me vendimin e tij 01Nr... të datës 27.10.2023 e kishte refuzuar ankesën e paditëses si të pa bazuar.

Nga provat e administruara dhe bazës ligjore të cekur si më lartë, gjykata ka vlerësuar se padia e paditëses është e pa bazuar, kjo para se gjithash se paditësja nuk ka prezantuar asnjë provë të besueshme për t'i vërtetuar pretendimet e saj se vendimi i Drejtorisë komunale në Drenas nr... i

datës 16.10.2023 me të cilin është përzgjedhur kandidati K.H është i kundërligjshëm. Me nenin 322 paragrafi 2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen parasheh se: *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Andaj, në bazë të LPK-së, barra e të provuarit bie mbi paditësen dhe e njëjta ishte e obliguar që gjatë shqyrtimit të kësaj çështje t’i ofroj prova gjykatës për besueshmërinë e kërkesëpadisë, gjë të cilën paditësja nuk ka arritur t’a bëjë.

Gjykata vlerëson se e paditura me rastin e procedurës së shpalljes së konkursit deri në marrjen e vendimit për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm nuk ka pasur shkelje ligjore sepse në konkursin e shpallur për vendin e punës mësimdhënës/e të lëndës E... me kohë të pa caktuar, kishin aplikuar 5 kandidat të cilët i kanë plotësuar kushtet ligjore për aplikim në kuptim të nenit 6 par.14 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, sipas të cilit si të kualifikuar për lëndën E... parasheh *“14.1 Niveli Master-pedagogji e përgjithshme muzikore; 14.2 Sistemi katërvjeçar dhe 14.3 Bachelor-pedagogji e përgjithshme muzikore”*. Testin me shkrim e kanë kaluar që të 2 kandidat, ku pas zhvillimit të intervistës, K.H ishte përzgjedhur si kandidat më i suksesshëm me 66.83 % të pikëve.

Ndërsa në lidhje me pretendimin e dhënë nga i autorizuari i paditëses se e paditura ka bërë diskriminim me rastin e përzgjedhjes së kandidatit K.H si mësimdhënës i lëndës E... nuk qëndron. Kjo për faktin se pala paditëse nuk ka dhënë fare arsyetim se çfarë lloji të diskriminimit ka kryer e paditura në raport me paditësen me rastin e mos përzgjedhjes së saj si fituese në vendin e punës. Në këtë drejtim, nuk mjafton që vetëm të përmendet shprehja diskriminim dhe në bazë të tij të merret vendimi në dëm të palës së paditur, pasi që në çdo rast duhet të jepet arsyetim i mjaftueshëm për llojin e diskriminimit, si është shprehur ai në raport me paditësen, sa ka ndikuar ky diskriminim (nëse do të kishte) në realizimin e të drejtave të paditëses. Si rrjedhojë, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 5 par.1 i Ligjit të Punës të Ligjit, për të provuar faktin e diskriminimit të paditëses nga ana e të paditurës, ngase komisioni përzgjedhës, pas zhvillimit të testit me shkrim dhe intervistës së kandidatëve në bazë të pikëve të mbledhura gjatë vlerësimit, ka përzgjedhur K.H si kandidatin më të suksesshëm me 66.83% të pikëve.

Gjykata ka vlerësuar edhe të provat tjera të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është e bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që paditësja nuk ka pasur sukses në procedurë ndërsa e paditura shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Andaj, vlerësuar nga të thënat si me lartë, duke u bazuar në nenin të 143 LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Dega në Gllgoc,
Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil,
C.nr.383/2023 me datë 28.05.2024**

Numri i lëndës: 2023:262529
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05801023

G j y q t a r i
Jeton Krasniqi

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.